

EXPOCITY
ALBANIA

ufi
Member

Beauty



14-15 *Dhjetor 2018*

Beauty EXPO

14-15
Dhjetor 2018



Në Expocity Albania, në datat **14-15 Dhjetor 2018** do të organizohet edicioni i parë i **Beauty Expo 2018** dedikuar produkteve të kozmetikës, të bukurisë, produkteve për flokë, thonj, sallone bukurie, kujdesit për veten, Spa-të etj.



Objektivi

Qëllimi i këtij organizimi është vendosja në qendër të vëmendjes e potencialit të këtij sektori, përfshirë kozmetikën, produktet/shërbimet e flokëve, produktet e bukurisë dhe spa-të në tregun shqiptar dhe atë rajonal, gjithashtu rritja e ndërgjegjësimit për përdorimin e produkteve të çertifikuara të kozmetikës dhe me kualitet.

Ky organizim me ekspozues të specializuar në fushat e sipërpërmendura por edhe në pajisje estetike, aksesore dhe orendi, është një platformë promovimi e mirëfilltë për aktorët kryesorë të sektorit sfida e të cilëve është orientimi i kësaj industrie drejtë një qëndrimi më profesional, të kontrolluar dhe në përputhje me zhvillimet teknologjike të fundit.





Ekspozuesit:

Pjesë e këtij organizimi dedikuar industrisë kozmetike do të jenë të gjithë distributorët e mëdhenj të këtyre produkteve për flokët, make-up, qendrat estetike, qendrat e kujdesit për lëkurën e fytyrës, për trupin, klinikat private, shkollat, institutet, distributorët e parfumeve, shpërndarës e rishitës për të gjitha kategoritë e sipërpërmendura etj.

Dy ditët e panairit do të shoqërohen me aktivitete të ndryshme si: klasa make up, seminare informuese e ndërgjegjësuese rreth risive në këtë industri si dhe oferta speciale nga ekspozuesit.

- Ekspozuesit e rinj do të kenë mundësinë që të prezantohen në treg dhe ata që kanë vite që operojnë të forcojnë pozitat e tyre dhe të tregojnë atributet e markës, cilësitë, dallimet që kanë me konkurrentët e tyre;
- Pjesëmarrësit do të promovojnë markat dhe të stimulojnë shitjet nëpërmjet ofertave të fundvitit, zbritjeve speciale, të rrjetëzojnë me aktorët kryesorë nga rajoni dhe më gjerë;
- Të marrin pjesë në diskutimet dhe seminarat e specializuara në lidhje me tendencat e fundit të industrisë;
- Të marrin pjesë në organizime për të promovuar shërbime të veçanta dhe produkte, masterklasa etj.





Vizitorët:

Janë të ftuar të vizitojnë Beauty Expo 2018 të gjithë:

- Konsumatorët
- Dyqane kozmetike
- Blerësit nga rajoni
- Markat e huaja (që dëshirojnë të hyjnë në shpërndarësit lokal / rajonal)
- Blerësit e dhuratave të fundvitit (shoqëritë, individët)
- Investitorët etj.

Për të marrë informacion mbi tendencat e fundit për produktet dhe shërbimet;
Për të përfituar zbritje të veçanta dhe marrëveshjet e fundvitit në produktet e paraqitura;
Për të marrë pjesë në seminare, master klasa ose mësimet të ofruara nga markat e ndryshme të bukurisë;

Ju ftojme të merrni pjesë në këtë vendtakim për konsumatorët finalë, për kompanitë, dyqanet kozmetike, blerësit nga rajoni, markat e huaja të cilat duan të partnerizohen me kompanitë shqiptare, investitorë shqiptarë e të huaj, me qëllimin e gjetjes së hapësirave për të realizuar partneritete e bashkëpunime të rëndësishme për biznesin tuaj. Gjithashtu, në prag festash Beauty Expo 2018 do të jetë një mundësi e mirë për të gjetur dhuratën e duhur.

Për më shumë informacion kontaktoni:

Project Manager

Elisabeta GJEBREA

C: +355 674000449 / +355 4 2387083

M: elisabeta.gjebrea@expocity.al

A: Tirana-Durrësi Highway 7th Km.

Tirana, Albania

M: www.expocity.al

